

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Konsumi i Energjisë në Ekonomi Familjare, 2022

05.09.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon hulumtimin me të dhëna për Konsumin e Energjisë në Ekonomitë Familjare. Ky publikim (hulumtim) statistikor paraqet të dhëna statistikore për vitin 2022 mbi konsumin e energjisë.

## Në Kosovë mesatarisht ngrohen rreth 52.67m<sup>2</sup> për ekonomi familjare

Konsumi i Energjisë në Ekonomitë Familjare (KEEF) është një studim i bazuar në një mostër probabiliteti, pra karakteristikat e popullsisë vlerësohen duke përdorur të dhënat e mbledhura nga njësitë e mostrës dhe duke aplikuar teorinë e probabilitetit.

Ky publikim do të përsëritet çdo katër vjet nga ASK-ja. Duke u bazuar në kërkesa të vazhdueshme nga shfrytëzues të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm dhe në bazë të indikatorëve që publikon EUROSTAT-i për statistika energjetike, janë prezantuar të dhëna me interes.

Qëllimi i publikimit është që të vë në dukje tendencën e zhvillimit të këtij sektori.

#### Konsumi mesatar vjetor i energjisë për një ekonomi familjare sipas llojeve të energjisë

Lloji i energjisë	Njesia	Ne zonat urbane	Ne Zonat Rurale	Total
Energji Elektrike	kWh	14,932.23	7,516.23	10,537.53
Nxemje	kWh	2,250.32	0.00	916.79
Benzin	Liter	0.03	1.64	0.04
Drunje	m <sup>3</sup>	4.73	5.51	5.19
Dizel	Liter	22.16	26.46	24.71
GLN	Liter	40.90	39.09	39.83
Thengjill	Ton	0.12	0.09	0.10
Panele Solare	kWh	18.99	10.63	14.04
Pelet	kg	0.75	0.83	0.79

Territori i Kosovës mbulohet 100% me energji elektrike, ndërsa për ngrohje përdoret dru zjarri në mesatare të 82,33% të ekonomive familjare.

**Konsumi i energjisë nga ekonomitë familjare (pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të amvisërive, në %)**

Lloji i energjisë	Në zonat Urbane	Në zonat Rurale	Total
Energjia Elektrike	100.00%	100.00%	100.00%
Nxemje për ngrohjen e hë	10.06%	0.00%	4.19%
Benzin	0.44%	0.55%	0.50%
Dizel	1.45%	2.15%	1.86%
Drunjë	68.60%	92.27%	82.33%
GLN	17.31%	18.20%	17.82%
Thëngjill	1.52%	2.10%	1.86%
Panele Solare	1.64%	0.91%	1.22%
Pelet	2.46%	2.70%	2.60%

Analizat e energjisë dhe lëndëve djegëse të konsumuara (sipas numrit të amvisërive) treguan se energjia elektrike është përdorur në 100,0% të ekonomive familjare, 4,19% nga ngrohja e blerë nga sistemet e ngrohjes qendrore.

Sa u përket lëndëve djegëse, dru zjarri ishte më i përdorur gjerësisht me një mesatare të përdorur në 82,33% të ekonomive familjare. Po ashtu, vend të konsiderueshëm merr edhe GLN (plin) me 17,8%.

Për më shumë informata lidhur me publikimin e Konsumi i Energjisë në Ekonomi Familjare, 2022, vizitoni <https://ask.rks-gov.net/Themes/Energy>